



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuša Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuša Belediyesi-Komuna e Mamushës Opština Mamuša-Municipality of Mamusa	
Çıkış - Dalëse - Izlaza - Outgoing	No.Nr. 17-21
Tarih/Dt.	28.05.2021

01 Nr. 17-21

Me 28.05.2021

Mamushë

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2 pika (d), neni 58 pika (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale , (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenit 45 pika (a) të Statutit të Komunës së Mamushës të datës 01.12.2008, Kuvendi i Komunës së Mamushës në seancën e mbajtur me datën 28/05/2021, miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Kodit të Etikës në Komunën e Mamushës

I

Miratohet : Kodi i Etikës i Komunës së Mamushës.

II

Ky Kod ka për qëllim të përcaktoj rregullat e sjelljes, veshjes si dhe masave ndëshkimore të shkeljes eventuale nga zyrtarët publik të Komunës së Mamushës dhe përfaqësuesit tjerë sipas rregullave dhe standardeve të vendosura në përputhje me frymën e etikës profesionale dhe morale të Komunës. Kodi synon zhvillimin e kulturës organizative të punës brenda institucionit për të forcuar dhe promovuar parimet bazë të etikës që do të zbatohen nga zyrtarët publik.

III

Pjesë përbërëse e këtij vendimi të cekur në pikën I është Kodi i Etikës dhe Deklarata e Pranimit.

IV

Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës së Mamushës.

V

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale si dhe publikimit në Faqen Zyrtare të Komunës.

Iu dergohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës;
- Drejtorët e Drejtorive;
- Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe
- Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Buyar Mazrek

